



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.380/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Adnan Konushevi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Besart Ademi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Yenilikçi Turk Hareket Partisi (YTHP), ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik, Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), për shkak të thyrjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 15.02.2021, mori këtë:

#### V E N D I M

**HUDHET** e pa rregullt ankesa Anr.380/2021, e datës 14.02.2021, e parashtruar nga Ertan Simitçi, dega në Prizren, për shkak të thyrjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021.

#### A r s y e t i m

Me datën 14.02.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.380/2021, të parashtruar nga subjekti politik Yenilikçi Turk Hareket Partisi (YTHP), me të cilën pretendon se në Prizren në afërsi të shkollës Motrat Qiriazit subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) ka hapur një zyre-lokal në afërsi të kësaj shkolle. Në vazhdim pretendojnë se në këtë lokal shihen një grumbull i njerëzve, kandidatëve, anëtarëve të kësaj partie të cilët insistojnë tek njerzit duke bërë presion te votuesit.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

#### **Ankesa është e parregullt**

Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e paraqitur nga subjekti politik Yenilikçi Turk Hareket Partisi (YTHP), është e parregullt, sepse ankesa në fjalë nuk është e nënshkruar nga parashtruesi i ankesës dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kërkesat ashtu siç parashihet me nenin 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ku theksohet se: *“Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari”*.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëcekur.

Nga arsyet e lartëcekura e në mbështetje të nenit 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.380/2021 më datën 15.02.2021.

**Kryesues i Panelit**  
Ferki Xhaferi



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.